



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

NJ O F T I M

Njoftohen aplikuesit se testimi me shkrim mbahet më datën : 16.08.2012 në ora 10.00 në lokalet e Fakultetit të Edukimit në Gjilan.

Testit me shkrim i nënshtrohen vetëm kandidatët e seleksionuar sipas kriterëve të konkursit dhe normativit Nr.13/2011, të datës 30/12/2011.

Për vendet e punës të ciklit klasor, testimit me shkrim i nënshtrohen vetëm kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në drejtimet përkatëse, sipas normativit Nr. 13/2011, të datës 30/12/2011. Pra, në testin me shkrim thirren kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet njërin nga drejtimet:

1. Fakulteti i Edukimit, programi fillor,
2. Fakulteti i mësuesisë

Për vendet e punës në mësim në Gjuhën turke, në shkollën fillore "Nazim Himet", "Musa Zajm" si dhe në shkollën e mesme Gjimnazi "Zenel Hajdini" kandidatët nuk do t'i nënshtrohen testimit me shkrim.

Kandidatët duhet të kenë letërnjoftimin, si mjet identifikimi.

Aplikuesit të cilët nuk janë ftuar në testim me shkrim (nuk kanë hyrë në listën e ngushtë) kanë të drejtë të paraqesin ankesë në afat prej 15 ditëve, në adresën e komisionit për shqyrtimin e ankesave pranë KK-së.

